

Nevoja për promovimin e barazisë gjinore në interpretimin e teksteve të shenjta

(qasjet tradicionale dhe reformatore)

Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim

Ju përshëndes të gjithëve përzemërsisht, e në veçanti reisu'l-ulemanë, dr. Husein ef. Kavazoviqin. E falënderoj drejtorinë për punë fetare pranë Rijasetit të BI të BeH për ftesën që të marr pjesë në këtë tubim të sotëm. Më lejoni që këtë gjysmë orën time ta shfrytëzoj në mënyrën më të dobishme dhe më ekspeditivë për të gjithë ne!

Shikoni, unë në vetë titullin e kësaj kumtese (që trajton nevojën e përfshirjes së gjithanshme të gruas në interpretimin e fesë) dukshëm kam shkruar dy fjalë ose dy përcaktime – njëra është tradicionale dhe tjetra reformatore, pra “feministe” dhe “liberale”. Debati midis tradicionales dhe reformatores në mesin e muslimanëve ka nisur në shekullin e 19-të dhe 20-të. Atëbotë, muslimanët dhe muslimanet, këtu e theksoj fjalën muslimanet, gjithnjë e më shumë inkuadrohen në shkrimin e veprave lidhur me këtë temë, i futen hulumtimit të problematikave lidhur me femrën, ndaj edhe me femrën muslimane. Në këtë kohë në skenë kemi atë që quhet pakënaqësi me literaturën klasike tradicionale, pakënaqësi me ato *tefsire* (komentime Kur’ani) të cilat ne i njohim për tradicionale, siç janë komentimet e Taberit (v. 923), të Ibni Kethirit (v. 1373), të Zemahsherit (v. 1144) etj., në të cilat botët e shumëfishta të interpretimit të fesë janë përshkruar shumë bukur, janë stabile, mirëpo për fat të keq nuk kanë asnjë kontakt të qenësishëm me realitetin e shoqërive muslimane të shek. 19-të dhe në fillimin e shek. 20-të.

Pikërisht lidhur me këtë pikë shumë muslimanë e muslimane, reformatore e reformatore, kanë parashtruar mjaft pyetje. Ata thoshin: Ne shumë mirë e kemi të përshkruar botën e tyre (kur kanë jetuar këta komentues – shën. i R.N), dimë shumë mirë për të çfarë mund të mësohet nga tekstet, mirëpo ne nuk i kemi të trajtuara në mënyrë efikase nevojat e botës së kohës sonë, pra të kohës të cilën ne do të duhej ta bënim më të këndshme, ta ringjallim me prosperitet, duke i plotësuar të gjitha të drejtat dhe detyrat tona, sipas të cilave edhe jetojmë në këtë botë.

Me këtë, do të kisha thënë, është theksuar dëshira për ta trajtuar kohën e tyre, pra shek. 19-të dhe 20-të, dhe kjo është një karakteristikë e përgjithshme e kësaj literature reformiste, “feministe” dhe “liberale”, e cila dalëngadalë u shfaq në mesin e muslimanëve dhe të muslimaneve.

Njëri ndër librat e parë që në këtë pikëpamje është më i rëndësishmi dhe i cili është botuar në gjuhën arabe, është emërtuar me fjalët *El-mer’etu el-xhedidetu – Femra e re*, ndërkaq libri i dytë bart titullin *Tahriru el-mer’eh – Emancipimi i femrës*. Të dy librat janë të të njëjtit autor, egjiptasit Kasimbeg Emin (v. 1908), i cili ka qenë nxënës i Muhammed Abduhu-së (v. 1905),

dhe teza e kryesore e të cilit është kjo: Veprat klasike që kanë folur për gruan muslimane dhe për burrin musliman nuk kanë kurrfarë kontakti me realitetin e sotëm. Kur'ani duhet të rizbulohet sërish me interpretime e me vepra komentuese të reja. Pikëpamjet kur'anore lidhur me burrin dhe gruan, me familjen, me fëmijët, me aktivitetet e gruas muslimane etj., duhen aktualizuar nga perspektiva e secilës kohë. Libri *Tahriru el-mer'eh* në gjuhën angleze zakonisht përkthehet me sintagmën *Liberation of woman*, mirëpo mund të përkthehet edhe me fjalët Emancipimi i gruas (*emancipation of woman*).

Teza kryesore e Kasimbeg Eminit ka qenë kjo: "Gjatë kolonializimit të tokave muslimane nga ana e Holandës, e Britanisë së Madhe, e Francës, e Spanjës, e Portugalisë etj., burrat e shoqërive të Lindjes së Mesme janë shtypur nga ana e kolonialistëve dhe nga ana e sundimtarëve të tyre lokalë. Njëra nga pasojat e kësaj situatë ka qenë që edhe vetë burrat muslimanë i kanë shtypur gratë, nënat dhe vajzat e veta. Me këtë vetëm sa është vazhduar linja apo hierarkia e shtypjes." Kasimbeg Emini thotë se në këto shtypje më së shumti vuan ai që është më i dobët, e kjo është gruaja, gruaja si nënë, si bashkëshorte, si vajzë, si motër etj.

Këtu është shumë me rëndësi të përmendim se argumentet e Kasimbeg Eminit janë shkruar nga pikëpamja e një interpretimi iluminist racional. Ai mundohet që në mënyrë objektive ta përshkruajë gjendjen e femrës, për shembull papunësinë e saj, ngatërresat që ndodhin në shoqëritë muslimane, dukurinë kur baballarët (ose prindërit) i kontraktojnë martesat në emër të bijave të tyre përkundër vullnetit të tyre etj. Kasimbeg Emini, si dhe autorët e tjerë të këtij orientimi, parashatrojnë pyetjen nëse statusi i këtyre femrës parashihet në Kur'an, nëse kjo ka qenë gjendja në shoqërinë e parë muslimane, në atë medinase, ose edhe në atë mekase. Natyrisht, këta autorë përreth Kasimbeg Eminit nxjerrin përfundime krejt të kundërta. Ata, nga pozicionet e tyre "liberale", pohojnë se muslimanët e shek. 19-të e kanë tradhtuar Kur'anin, e kanë tradhtuar atë vizionin e vetëm prosperitar, lirinë, të cilën e afirmon Kur'ani, si për njërin ashtu edhe për gjininë tjetër, si dhe bashkëpunimin e tyre për të mirën reciproke.

Kasimbeg Emini ka pasur ndjekësit e shumtë, ndërkaq edhe ai, siç thashë, ka qenë ndjekës i mësimëve dhe i projekteve arsimore të Muhammed Abduhusë. Kasimbeg Emini nuk mendon se mësimet e Islamit janë fajtores për pozitën e nënçmuar dhe për "prapambetjen" e femrës muslimane ose përgjithësisht të asaj në Lindjen e Mesme (pasi edhe pozita e femrës krishtere dhe çifute në Lindje nuk ishte më e mirë asokohe). Kasimbeg Emini pohon se tirania e pushtetit, e sundimtarëve dhe e institucioneve ekzistuese ishte burimi i mirëfilltë i shtypjes së femrës në shoqëritë e asaj kohe.

Pra, siç mund të shihni, kjo literaturë që zë fill me Kasimbeg Eminin (*Tahrir el-mer'eh, El-Mer'eh el-xhedideh* etj.), synon të flasë në mënyrë objektive për pozitën shoqërore të femrës. Kjo literaturë nuk flet as për Kur'anin e as për hadithet me përbuzje (besoj se e keni të njohur faktin se sot kemi boll literaturë të këtyre përbuzëse, "ankuese" të pafrytshme rreth Kur'anit e të ngjashme).

Kërkesa e Kasimbeg Eminit është krejt tjetër, ai është i vetëdijshëm se Kur'ani ka ardhur për ne njerëzit, e jo ne njerëzit për Kur'anin! Kur'ani është këtu për të mirën e gjinisë njerëzore, po ashtu edhe hadithet janë për të mirën tonë dhe për ngritjen tonë morale dhe jetësore. Pra, Kasimbeg Emini synon t'i qaset realitetit të fundshekullit 19-të dhe fillimit të shek. 20-të,

synon ta përshkruajë ashtu siç e sheh ai – përpiqet të jetë i sigurtë prandaj edhe flet me keqardhje për disa gjëra. Ai flet për femrat e arsimuara në Kajro, për mundësitë, për shanset e barabarta etj. Mirëpo ai gjithandej vëren se femra është e marginalizuar si bashkëshorte, si bijë, si nënë, si anëtare e shoqërisë. Ai në një vend bile shkruan se muslimanët gjysmën e popullsisë së tyre e kanë prangosur në burg, e kanë burgosur...

Vazhduesja e ideve të tij është një mësuese nga Kajro, Nebevijja Musa. Ajo ka shkruar veprën *El-mer'etu vel-'amelu* (Gruaja dhe puna/karriera). Autoren Nebevijja Musa në radhë të parë e preokupon angazhimi në punë i gruas. Pse? Për këtë ajo ka pasur arsye të drejtpërdrejta personale. Ajo ishte punësuar në një shkollë në Kajro dhe kishte marrë rrogë më të ulët se mësuesit meshkuj – këtë e kishin pasur interpretuar me ajetin: *lidh-dhekeri mithlu hadh-dhi'l-unthejejn – mashkullit i takon hise* (në trashëgimi) *sa dy femrave* (en-Nisa', 4:11).

Nebevijja Musa e ka kundërshtuar këtë lloj të interpretimit të Kur'anit, sikur të ishte një "fjalë e çimentuar". Ajo synon interpretimin dinamik të Kur'anit, synon barazimin e shanseve në punë midis femrës dhe mashkullit. Në këtë vepër ajo është marrë me barazinë gjinore në karrierë në shoqëritë tradicionale muslimane, ka kërkuar paga të barabarta, me këtë ka kërkuar edhe qasje të barabartë të gruas në tregun e punës. Natyrisht, ajo nuk ka arritur ta realizojë këtë në kohën e saj, mirëpo zëri i saj ka qenë tejet i rëndësishëm.

Autori i radhës që do ta kisha theksuar këtu është Tahir el-Haddad-i, një tunizian i cili në vitin 1935 e boton librin e tij *Imra'etuna fi'sh-Sheri'ati ve'l-muxhteme'i* (Gruaja jonë në Sheriat dhe në shoqëri). Në këtë vepër el-Haddadi i vë përballë njëra-tjetrës dy gjëra: në njërin anë e kemi Sheriatin e në anën tjetër "shoqërinë tonë". Sipas el-Haddadit, në "shoqërinë tonë" gruaja nuk ka shanse, ajo është e marginalizuar... Ai angazhohet për riinterpretimin e normave të Sheriatit, angazhohet për një qasje dinamike të Sheriatit, si dhe për zbulimin e mundësive të reja për një afirmim dinjitoz të pozitës së femrës në shoqëri.

Në të vërtetë Tahir el-Haddadi pretendon se muslimanët e kanë tradhtuar Sheriatin, e kanë interpretuar atë në mënyrë të ngurtësuar, nuk e kanë interpretuar si proces, porse si një fjalë të gatshme e cila mënjanon çfarëdo lloj mundësie dinamizmi.

Libri i el-Haddadit bën pjesë në atë lloj të literaturës për gratë muslimane e cila dëshiron rileximin e Kur'anit dhe të haditheve në kontekst të çështjeve, nevojave dhe problemeve të kohës. Prandaj, s'është për t'u habitur se ky lloj literature Kur'anin e shikon si një burim çlirues, si një tekst që është shpallur për çlirimin tonë. Në të njëjtën mënyrë ose në një të përngjashme me këtë ajo i shikon edhe hadithet. Pra, edhe thesarin e haditheve duhet shikuar si një proces, e jo si norma të gdhendura në gur e të cilat nuk e trajtojnë dinamizmin e kohës dhe nevojat e saj të veçanta.

T'ju kujtoj se këtu te ne (në Bosnjë – R.N.) këtë lloj të literaturës e ka ndjekur për së afërmi prof. Mehmet Begoviqi, nga mesi i shek. 20-të. Ai edhe vetë ka shkruar një libër për pozitën dhe detyrat e gruas muslimane ndaj shkencave islame në frymën e kohës së sotme. Ky libër në fakt është një seri ligjëratash të cilat prof. Begoviqi i ka mbajtur në konviktin e studenteve të shoqatës kulturore beogradase "Gajret", në nëntor të vitit 1930. E theksoj faktin se edhe sot për ne është shumë me rëndësi të dimë se në ç'mënyrë prof. Mehmet Begoviqi i ka analizuar të ashtuquajturat *çështje grash* në kontekst të interpretimit të tij të burimeve islame.

Në qoftë se i kthehemi sërish temës sonë, më duhet të them se ngritja shoqërore e kulturës dhe e qytetërimit perëndimor, si dhe mënyra se si Perëndimi e ka realizuar emancipimin e gruas me anë të instalimit të institucionit të qytetarit, sigurisht që krejt kjo ka nxitur shumë autorë e autore muslimane që t'i qasen rileximit të burimeve islame dhe të trashëgimisë islame në përgjithësi, krejt në kontekst të afirmimit shoqëror të gruas muslimane.

Në këtë lloj të ri të literaturës muslimane “femërore” lidhur me Islamin dhe Kur’anin, Kur’ani shikohet si një tekst i hapur i cili nuk është i mbyllur në shtatë dryna brenda parametrave të lashtë të komentimeve klasike të Kur’anit. Kjo literaturë sikur dëshiron të na thotë këtë: Kur’ani në shekullin e 7-të i ka dhënë shumëçka femrës, të drejtën e dinjitetit, të adhurimeve, të trashëgimisë, të kontratave etj. Mirëpo, Kur’ani nuk i kundërvihet asaj që edhe vetë shoqëria nga vetvetja, nga ana e saj, gruas t’i japë akoma më tepër në shumë fusha ku ajo mund të afirmohet në mënyrë dinjitoze. Prandaj, kjo literaturë e re “feministe” muslimane e parashtron pyetjen e qasjeve relevante ose valide ndaj traditës klasike islame.

Kryesisht konstatohet se komentuesit klasikë të Kur’anit në pikëpamjet e tyre lidhur me gruan kanë shkuar shumë nën standardin e vetë Kur’anit. Literatura më e re “feministe” muslimane dëshiron ta korrigjojë këtë ose më së paku ta tematizojë.

Me fjalë të tjera, “feministet” muslimane në literaturën e sotme shpesh tentojnë ta theksojnë dallimin midis pikëpamjes së gruas si besimtare nga aspekti kur’anor, nga njëra anë, dhe nga aspekti i korpusit të traditës, në anën tjetër. Ky korpus shpesh nuk ka qenë dashamir i gruas, i femrës. Për fat të mirë sot botohen shumë libra, si p.sh. në Kajro dhe në Teheran, autorët e të cilëve janë femra muslimane dhe të cilat theksojnë se Kur’ani është shumë më “liberal” në çlirimin e gruas dhe të njeriut, sesa korpusi klasik i haditheve dhe i komentimeve të tyre. Me fjalë të tjera, është ardhur në përfundimin se sa më shumë që i është larguar shekullit 7-të, kur është shpallur Kur’ani, në disa nivele ka ardhur deri te ngurtësimi i pikëpamjeve lidhur me rolin e gruas muslimane në shoqëri.

“Feministet” e sotme muslimane me theks të veçantë i trajtojnë përmbledhjet e haditheve të shekullit të dytë, të tretë e të katërt të Islamit dhe arrijnë në përfundimin: sa më këndeje që të vijmë, aq më e dobët është pozita e gruas midis kopertinave të komentimeve të haditheve, ndërkaq ky ka qenë edhe procesi i gjithmbarshëm që vihet re edhe në mbarë shoqërinë muslimane.

Më tutje, “feministet” muslimane e vënë në pah mesazhin etik dhe shpirtëror të Kur’anit, i cili ka qenë jashtëzakonisht egalitar, barazimtar. Ashtu siç barazohet gruaja muslimane me burrin musliman në “të drejtën e besimit në Zot” si dhe në normat e tjera që aq shumë përmenden në Kur’an, në të njëjtën mënyrë ajo do të duhej të ishte e barabartë edhe në punët shoqërore (punë, karrierë, qeverisje, ngritje kulturore etj.). Gruaja muslimane është banore e barabartë në ndërtesën e ritualeve të Islamit, e pse të mos jetë kështu edhe kur janë në pyetje angazhimet e përmendura shoqërore? – pyesin “feministet” e sotme muslimane.

Siç mund të shohim nga këta shembuj, “feminizmi” musliman është i hapur, ai është i drejtpërdrejtë, ai nuk ngurron të parashtojë pyetje, ai nuk miklohet, ai dëshiron të flasë hapur për çështjet që sot janë të rëndësishme për gruan në shoqëritë muslimane.

Nga ana tjetër, “feministet” muslimane gjithsesi se janë të vetëdijshme edhe për rrezikun e madh që lufta për të drejtat e gruas në botën muslimane të keqpërdoret për “qëllime

imperialiste". Për këtë arsye, ato dëshirojnë që në mënyrë autoktone, pa ndikim nga jashtë, të thonë se çfarë mund të ofrojë sot Kur'ani në drejtim të emancipimit të femrës muslimane.

"Feministet" muslimane po ashtu vënë në pah nevojën se reforma duhet të vijë nga brenda. Duke punuar për këtë ato dëshirojnë të bëjnë diçka të mirë në jetën fetare. Pra, kjo është dëshira e "feministeve": që feja islame të jetë gëzim dhe lumturi e jo e interpretuar si mundim, si diçka e trishtueshme, e vështirë dhe neveritëse.

Le të përmendim tani disa "feministe" muslimane. Fatima Mernisi është njëra ndër më të rëndësishmet, e cila ka shkruar mjaft libra, ndër ta edhe *Women and Islam* (Gratë dhe Islami), ku kjo autore bën një hulumtim ose një analizë historike dhe teologjike përbrenda Kur'anit dhe haditheve, për ta gjetur frymën e hershme barazimtare të Islamit. Po ashtu, Fatima Mernisi flet për arbitraritetin mashkullor kur është në pyetje *hixhabi*, mbulesa e muslimanes. Mjafton të shikohet slogani: *the veil and the male elite* (Mbulesa dhe elita mashkullore).

Shumë me rëndësi është edhe autorja me emrin Kecia Ali, po ashtu profesoreshë e studimeve islame në shumë universitete. Ajo i trajton çështjet e përgjithshme të "feminizmit" musliman të sodit, e në veçanti angazhohet për reformimin e martesës, e cila nuk duhet të shndërrohet në një institucion ku vjen deri te uzurpimi i të drejtave, në veçanti jo uzurpimi i të drejtave të gruas (bashkëshortes) si gjoja pala "më e dobët" a priori.

Pakistano-amerikanja Esmā Barlas është edhe një autore tjetër me rëndësi nga ky lloj i literaturës. Ajo e ka shkruar librin "*Believing Women*" in Islam: *Unreading Patriarchal Interpretations of the Qur'an* ("Besimtarët gra" në Islam: mosleximi i interpretimeve patriarkale të Kur'anit).

Krahas Esmā Barlasit duhet përmendur edhe Amina Wadud, e cila e ka shkruar librin *Qur'an and Woman – Reading the Sacred Text from a Woman's Perspective* (Kur'ani dhe gruaja – leximi i Librit të Shenjtë nga këndvështrimi i një gruaje).

Ju tërheq vëmendjen edhe në veprën *The Oxford Encyclopedia of Islam and Women* (Enciklopedia e Islamit e Oksfordit dhe gratë), e publikuar para një kohe në dy vëllime të mëdha.

Në fund të kësaj kumtese do të kisha thënë se për ne kjo literaturë "feministe" muslimane ose islame ka shumë rëndësi. Ajo është vënë në kërkim të "Islamit realist" (*el-Islamu'l-vaki'ijj*) dhe nuk dëshiron të nxjerrë përfundime rreth pozitës së gruas në Islam vetëm në bazë të librave (*el-Islamu fi's-sutur*), e aq më pak në bazë të atyre komenteve që janë shkruar qëmoti dhe që nuk mund të kenë asnjëfarë komunikimi të vlefshëm me kohën tonë.

Kjo literaturë dëshiron të flasë singërisht për problemet e shoqërive muslimane në kontekst të çështjeve të grave ose të statusit të tyre në Islam.

Titulli origjinal: "O potrebi promoviranja ravnopravnosti žena i muškaraca u tumačenju svetih tekstova – tradicionalni i reformatorski pristupi"

Nga boshnjakishtja:
Rejhan Neziri